



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 15535 Prot

Lezhë, më 19 / 09 /2022

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Lezhë

Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Lezhë

Për dijëni: Kryetarit të Bashkisë Lezhë

Për dijëni: Prefektit të Qarkut Lezhë

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”, neni 53 pika 2, pika 4, neni 56, pika 2 shkronja “a” dhe në Rregulloren e Këshillit të Bashkisë Lezhë, e miratuar me VKB nr. 54, datë 28.04.2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë me shkresën nr.prot. 358/1, datë 15.05.2020, njoftoj thirrjen e **mbledhjes së radhës (Shtator 2022)** të Këshillit Bashkiak Lezhë, ditën e **premtë**, në datën **23.09.2022**, në orën **12:00**, në sallën e **Qendrës Kulturore të Fëmijëve**, me këtë

REND DITE:

1. Interpelancë me Kryetarin e Bashkisë në lidhje me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore kërkuar nga këshilltari Agostin Marku
2. Projekt-Vendim “Për dhënien e mandatit si anëtar i Këshillit të Bashkisë Lezhë Z. Gjon Ndoci”
3. Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Gusht 2022”
4. Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të kontingjencës, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2022”
5. Projekt-Vendim “Për miratimin e PBA-së 2023-2025 të Bashkisë Lezhë (Faza e Dytë)”
6. Projekt-Vendim “Për një shtesë dhe ndryshim në V.K.Bashkiak nr.177, datë 23.12.2021 “Për miratimin e Buxhetit për vitin 2022 dhe PBA-së 2022-2024”
7. Projekt-Vendim “Për një shtesë e ndryshim në buxhetin e Bashkisë Lezhë për vitin 2022 dhe PBA-në 2022-2024”
8. Projekt-Vendim “Për disa ndryshime në VKB nr. 177, datë 23.12.2021 “Për miratimin e Buxhetit për vitin 2022 dhe PBA-së 2022-2024”
9. Projekt-Vendim “Për normat e harxhimit të karburantit dhe mbajtjes në punë dhe në gadishmëri për mjetet e Bashkisë Lezhë”
10. Projekt-Vendim “Për miratimin e ndryshimit të emërtimit të rrugës nr. 03130037, në fshatin Patalej, Njësia Administrative Kolsh, nga rruga “Papa Gjon Pali II”, në rruga “Carmen Hernandez””
11. Të ndryshme

Grafiku i mbledhjeve të komisioneve:

Nr	Komisioni	Dita	Data	Ora
1	Komisioni Juridik	E enjte	22.09.2022	10:00
2	Komisioni i Mirëqenies Sociale	E enjte	22.09.2022	10:15
3	Komisioni i Ekonomisë dhe Financave	E enjte	22.09.2022	10:30
4	Komisioni i Shërbimeve Publike	E enjte	22.09.2022	11:00
5	Komisioni i Kulturës, Trashëgimisë Kulturere, Dhënies së Titujve, Emërtimeve	E enjte	22.09.2022	11:15

**KRYETARI
NDUE LULI**

